



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORTITETI KONTRAKTOR

BASHKIA BULQIZE

Nr ____prot

Bulqize më, 17.12.2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Per hartimin e planit te mbareshtrimit te ekonomise pyjore kullosore Zerqan, NjA Zerqan , Bashkia Bulqize”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **77231000-8**

VLERA E FONDIT LIMIT: : 9 976 833 (nente milion e nenteqind e shtatedhjte e gjashte mije e teteqind e tridhjte e tre) leke pa tvsh, e ndare perkatesisht ne dy vite per vitin 2024 me nje vlere prej 2 500 000 (dy milion e peseqind mije)leke pa tvsh dhe per vitin 2025 ne nje vlere prej 7 476 833 (shtate milion e katerqind e shtatedhjte e gjashte mije e teteqind e tridhjte e tre) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Bulqize hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”

Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Kandidati/ Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres së Fondit Limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet_“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..**”
2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,**”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) pika 4, paragrafi 2: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, **duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**”

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve të fundit 2022, 2023 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që te tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit . Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar). Neni 43/ 4 ”Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, (nuk kanë detyrime të prapambetura) në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

* Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së, i ndryshuar. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Bulqize, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara

sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislationit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) citohet:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj marrëveshje kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/c dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**;... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 3** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit...

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

Ndërsa në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: **b)** Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia përcaktoj kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit që provon kryerjen e shërbimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Operatori ekonomik/ofertuesi duhet të paraqesë licence në kategorinë III.7, “Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë. Referuar Vkm nr 805, date 20.12.2021” Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të këshillit të ministrave, “për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar”

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4, germa (a) e nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose si dhe ne VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullave te tjera nënligjore të përbashkëta" e ndryshuar

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë një staf pune të kualifikuar.

a) 1 (nje) Inxhinier pyjesh (drejtues teknik) për të realizuar një planifikim shumë – funksional, për hartimin e metodikës, organizimin e stafit, planin e veprimit, grafikun e realizimit punimeve, mbrojtjen e studimit, si drejtues i grupit te punes)

Kontraktori duhet të paraqes dokumentacionin vërtetues të mëposhtëm:

- Kontratën e punës e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë e Studimeve Universitare e Fakultetit të Pyjeve.
- Çertifikatën, si ekspert në fushën e pyjeve dhe të kullotave
- CV. Jetëshkrim mbi aktivitetin profesinal.

b)1 (nje) Inxhinier Pyjesh, i Licencuar , lëshuar nga Institucionet e autorizuara për lëshimin e licencave. Të vertetuar me paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë e Studimeve Universitare e Fakultetit të Pyjeve.
- Licence Professionale Individuale “Për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtëshme Tokë Bujqësore, Tokë pyjore, kullotë, livadh dhe tokë të pafrytëshme”, lëshuar nga Institucionet e autorizuara për lëshimin e Çertifikatave, Licencave (MIE).
- CV. Jetëshkrim mbi aktivitetin profesinal.

c) 1 (një) Inxhinier Gjeodet, i licencuar, lëshuar nga Institucionet e autorizuarra për lëshimin e licencave. Të vertetuar me paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë e Studimeve Universitare e Inxhinierit Gjeodet
- Licensen perkatese
- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesional.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në "Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 "Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik". Bazuar në kërkesat e germës A1 "Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik" dhe germës D.1.1 "Perberja e ekipit të punës", të Manuali i planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, të pikës 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në pikën 4 të germës b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". b) **një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose**

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

Me ane të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë "fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit", që kanë në dispozicion apo që mund të vihet.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që priten të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin specialist është përllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjesëtim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

2.3.4 Përveç stafit teknik kryesor sa sipër, operatori duhet të paraqes një staf ndihmes si me poshte:

a) Kandidati ofertues duhet të kete pjese te stafit 1 (një) Biolog. Të vertetuar me paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë e Studimeve Universitare Në fushën e Studimeve Biologji.

- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesinal.

b) Kandidati ofertues duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) Agronom. Të vertetuar me paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë e Studimeve Universitare në Degën e Studimeve Agronomi
- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesinal.

Kriteri 2.3.4, pika a, b, do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumenti: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në "Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019 "Kontrolli i disponibilitetit dhe aftësive profesionale të stafit teknik", si dhe në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 41, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

Inxhinieri i pyjeve si ekspert i studimeve specifike në bashkëpunim me Biologun mbështetur në kërkesat e germave E.5.6 Biodiversitetin, E.5.7 Prania e vlerave konservuese të larta dhe E.5.8 Rreziqet mbi biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin, si dhe të kërkesave të tjera të "Manuali i planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave", të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019".

Specialistet e fushës do të vlerësojnë se Plani i Mbarështimit mbart në vetvete edhe procesin e mbledhjes së të dhënave mbi biodiversitetin, që do të grumbullohen nga vrojtimi në terren gjatë fazës së përshkrimit të parcelar.

Te dhënat kryesore duhet të fokusohen në:

- biotopet (Standartin 5)
- habitatet
- speciet e kërcënuara (Anneksin 10)
- vegjetacionin potencial (Anneksin 11)
- rezervat biogjenetike

Eshtë e nevojshme që të grumbullohen edhe të dhëna nga studime të tjera dhe të integrohen në planin e mbarështimit si: raportet ekologjike, planet e vjetra të mbarështimit dhe publikime të tjera (si psh: Rrjeti i Natyrës 2000 për habitatet) dhe informacioni lokal. Duhet të përcaktohet një listë me elementet ekzistues të biodiversitetit në Ekonomine Kullësore Rrezome duke iu referuar kategorive të mëparshme dhe parcelave dhe të paraqiten ato në hartën e planit. Duhet të përshkruhet rëndësia dhe impakti mbi ekosistemet.

Studimin e kushteve stacionale dhe edafike. (tokën, gjeologjinë, hidrologjinë, erozionin,)

Eshte e nevojshme qe te grumbullohen edhe te dhena nga studime te tjera dhe te integrohen ne planin e mbareshtimit si: raportet pedologjike dhe informacioni lokal. Duhet te percaktohet nje liste me elementet ekzistues te tipeve dhe nentipeve te tokes, struktura dhe pjelloria e saj, elementet kimik dhe perberja fizike ne Ekonomine Kullosore Rrezome duke iu referuar kategorive te meparshme dhe parcelave dhe të paraqiten ato ne harten e planit. Duhet te pershkruhet rendesia dhe impakti mbi token.

Të gjitha proceset e mesiperme, realizohen nga bashkëpunimi inxhinier, biolog e agronom i kontraktuar nga kandidatet ofertues.

- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 30.12.2024, ora 10.00**, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

NJËSIA E PROKURIMI